



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1177 Prot.

Durrës, më 29.7 2022

VENDIM

Nr. 39, datë 29.7 2022

"Për një shtesë në planin e përdorimit të të ardhurave të vitit 2022".

Në mbështetje të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", nenit 49, gërma c, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Regulloren Financiare të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, kontratën e nënshkruar me datë 17.02.2022 mes Fakultetit të Biznesit të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, dhe ekspertes Blendis Bocari, respektivisht artikulli 29, shkresën nr. 585/1, datë 31.03.2022 e objekt "Kërkesë për kryerjen e pagesës në kuadër të aktivitetit të projektit "MISTRAL", Interreg Mediterranean", të ekspertes së jashtme Blendis Bocari", paraqitur nga drejtuesja e projektit Prof. As. Dr. Azeta Tartaraj, shkresën nr. 809, datë 18.5.2022 të drejtueses së projektit "MISTRAL", Vendimin nr. 48, datë 28.07.2022 të Senatit Akademik "Për një shtesë në përdorimin e të ardhurave të vitit 2022", relacionin e hartuar nga Drejtoria e Administrimit Financiar, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Një shtesë në përdorimin e të ardhurave të vitit 2022, në vlerën 604 000 lekë, të cilat do të përdoren për financimin e shpenzimeve të mbetura për mbylljen e projektit "MISTRAL".
2. Shpenzimet e kryera nga të ardhurat e Institucionit, për mbylljen e projektit "MISTRAL" do të rimbursohen në llogarinë e të ardhurave të Institucionit nga fondet e disbursuara nga lideri i projektit pas çertifikimit të shpenzimeve të projektit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Administratori
 - Drejtoria e Administrimit Financiar
 - Drejtuesja e projektit "MISTRAL"
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Ada ALIAJ

